



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivuty	12-05-2021	viti god year	
Organ/Njesia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Bj Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	2377	2021	119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.297/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1136/18 të datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.137/2018 të datës 14.03.2018 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rruga “Bedri Pejani”, H 4, Nr. 16 në Komunën e Fushë Kosovës, kundër Vendimit me protokollin 332/18 të datës 07.03.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET pjesërisht si bazuar** ankesa me numër A.nr.137/2018 e datës 14.03.2018 e parashtruar nga ankuesi e rishqyrtuar sipas Aktgjykimit Anr.1136/18 të datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi Ka.nr.02/18 me protokollin 332/18 i datës 07.03.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Themelore në Prishtinë.
- III. **OBLIGOHET** Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e tij, duke bërë kompensimin e dy (2) pagave me rastin e pensionimit në vlerën e pagës së fundit dhe një (1) pagë jubilarë në vlerë të një page mujore sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës për ankuesin
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi punësuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë në pozitën “Referent”, në bazë të Vendimit me numër protokollin 732/17 të datës 02.06.2017 të nxjerr nga Kryetarja e Gjykatës



Themelore në Prishtinë i është përfunduar marrëdhënia e punës me rastin e pensionimit më datë 02.07.2017 duke i njohur edhe të drejtën e një page me rastin e pensionimit të cilën ankuesi në bazë të dëshmisë (listës se pagave për muajin korrik 2017) e ka pranuar.

Ankuesi i pakënaqur me mos pagesën e tri pagave me rastin e pensionimit, më datë 22.02.2018 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Gjykatës Themelore në Prishtinë, më datë 07.03.2018 nxjerr Vendim me Nr. 332/18 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin Nr. 332/18 të datës 07.03.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me datë 14.03.2018 parashtron ankesën me numër protokollit 1479/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se për pagesën e pagave me rastin e pensionimit sipas Kontratës Kolektive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Gjykata Themelore në Prishtinë për përgjigje në ankesë më datë 19.03.2018. Këshilli më datë 29.03.2018 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Gjykata Themelore në Prishtinë me provat e bashkangjitura faqe 1/08.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 04.04.2018 ka nxjerr Vendim A.nr.137/2018 me të cilin ka hedhë poshtë si të palejuar ankesën e ankuesit. Ankuesi kundër vendimit të Këshillit ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 01.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1136/18 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar vendimin e Këshillit dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1479/2018 të datës 14.03.2018 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr. 332/18 të datës 07.03.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Vendimin Nr. 732/17 të datës 02.06.2018 të Kryetares se Gjykatës për pensionimin e ankuesit; Listën e pagave qershor dhe korrik 2017; Procesverbalin për këshillim dhe votim Ka.nr.02/18; Ankesën e datës 22.02.2018 e parashtruar nga ankuesi në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve; Kërkesë për pagës retroaktive datë 10.07.2017; dhe Ankesave dhe Përgjigja në ankesë e datës 29.03.2018 me numër protokollit 1805/2018 nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Aktgjykimin A.nr.1136/18 të datës 01.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigje në padi e datës 03.03.2012; Aktvendimin A.nr.1136/18 i datës 10.12.2020; Padinë e datës 15.05.2018; Vendimin A.nr.137/2018 I datës 04.04.2018 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për prova shtesë e datës 29.04.2021 dhe Përgjigjen e datës 11.05.2021..

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas rishqyrtimit të ankesës së ankuesit dhe provave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit ***është e pjesërisht e bazuar, sepse:***

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, më datë 29.04.2021 ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë provat si në vijim: Vërtetimin e përvojës së punës së (sa vite përvojë pune ka në gjykatë); Dëshminë nëse ankuesit ndonjëherë i është paguar ndonjë pagë jubilarë në shërbimin Civil dhe Dëshminë kur ankuesit i është paguar një page me rastin e pensionimit, mirëpo më datë 11.05.2021 kemi pranuar përgjigje se: "*Pas kontrollimit të dosjes të z. ish Referent në Gjykatën Themelore në Prishtinë, nuk kam gjetur Vendim të përvojës së punës, por nëse*

ju kryen punë lista e pagave e muajit qershor të vitit 2016 ku shënohet përvoja e punës po ju dërgoi në attach. Ndërsa dëshmi te pagesës te një page pas pensionimit ne dosjen e tij kam gjetur këtë document (pergjigjeje ne kërkesën e tij) nga Administratori”.

Pas pranimit të përgjigjes, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar provat e lëndës, dhe pretendimet ankimore të ankuesit, i cili kërkon kompensimin e tri pagave me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë konstaton se ankuesi me rastin e përfundimit të marrëdhënies së punës si rezultat i arritjes së moshës së pensionimit ka përfituar një pagë sipas depozitave e nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, atëherë duke u bazuar edhe në praktikën vendimmarrëse të Gjykatës së Apelit të Kosovës, e cila në aktgjykimet për objektin e njëjtë të lëndës palëve u është njohur e drejta e kompensimit sipas Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive, për këtë arsye Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka filluar të zbatohet për tri (3) vjet nga 01.01.2015, në këtë rast kjo marrëveshje për kohën sa ka qenë në fuqi është zbatuar edhe për nëpunësit e administratës shtetërore.

Duke pasur parasysh që ankuesi ka përfituar një pagë me rastin e pensionimit, atëherë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive i punësuarit, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt te fundit, siç përcaktohet me nenin 53 te Marrëveshjes se Përgjithshme Kolektive, i cili përcakton se: ***“I punësuarit, me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marr për tre (3) muajt të fundit”***, rrjedhimisht Gjykata Themelore në Prishtinë është e obliguar që ankuesit në emër të pagës përcjellëse të pensionimit t’i bëjë kompensimin edhe dy (2) pagave të tjera ne vlerën e pagës së fundit, kështu që pretendimi i ankuesit për kompensim të dy pagave është i bazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit i cili pretendon për kompensim të tri (3) pagave jubilarë të përvojës së punës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të dokumentacionit të ofruar nga Gjykata Themelore në Prishtinë nuk dëshmohet se ankuesi ka përfituar ndonjëherë pagë jubilarë, ndërsa në Republikën e Kosovës fillimisht bazë për themelimin e marrëdhënies respektivisht shërbimit civil është krijuar me Rregulloren 2001/36 e cila ka hyrë në fuqi më datë 22 dhjetor 2001, me çka nënkupton se shërbimi civil ka filluar të funksionoj nga viti 2001, ndërsa të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shërbyesve civil e që rregullohen me ligjet dhe aktet nënligjore të tanishme, janë të aprovuara pas nxjerrjes së kësaj rregulloreje, mbi bazë të kësaj edhe kompensimin jubilar mund të kompensohet vetëm nga viti 2001 kur është krijuar shërbimi civil.

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se, ankuesi nuk ka përvojën e punës në shërbimin civil më shumë se 17 vite përvojë të punës rrjedhimisht në bazë të kësaj nuk i takon kompensimi jubilar në vlerën e tri (3) pagave, sepse shpërblimi jubilar bëhet për çdo dhjetë (10) vite përvojë të punës pa ndërprerë, kështu ankuesi në bazë të provave të lëndës përfiton vetëm një (1) pagë nga shpërblimi jubilar siç parashihet me dispozitat e nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, është përcaktuar që: ***“I punësuarit, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij”***, bazuar në këtë pretendimi i ankuesit është pjesërisht i bazuar, rrjedhimisht Gjykata Themelore në Prishtinë obligohet që në emër të shpërblimit jubilar ankuesit ti bëjë kompensimin e një page në vlerën e pagës së tij të fundit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, se Vendimi Ka.nr.02/18 me protokollin 332/18 i datës 07.03.2018 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Gjykatës Themelore në Prishtinë, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.




Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 297/2021

Avdyl BEKTESHI
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- Administratorit të Gjykatës Themelore në Prishtinë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

